



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT PROFESIONAL 2022-2026

DHE

PROGRAMI I TRAJNIMIT 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

1	HYRJE.....	3
2	VIZIONI	4
3	MISIONI.....	4
4	OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË SISTEMIT KOMBËTAR STATISTIKOR	4
5	SITUATA AKTUALE	4
6	VLERËSIMI I NEVOJAVE TË TRAJNIMIT DHE GRUPET E SYNUARA	6
7	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	8
8	METODOLOGJIA E TRAJNIMIT.....	9
9	VLERËSIMI DHE MONITORIMI I PERFORMANCËS SË TRAJNIMIT	10
10	TRAJNIMET E OFRUARA DHE CAKTIMI I PJESËMARRËSVE	11
	PROGRAMI VJETOR I TRAJNIMIT	12

1 HYRJE

Në kushtet e progresit të vazhdueshëm të proceseve dhe metodave të prodhimit statistikor, INSTAT ka ndërmarrë nismën për hartimin e një strategjie dedikuar ngritjes së mëtejshme të kapaciteteve profesionale për të siguruar mundësinë dhe gatishmërinë për tju përgjigjur kërkesave të brendshme dhe të jashtme gjithnjë e në rritje për të dhëna statistikore.

Duke qenë se stabiliteti na garanton të tashmen, por ndryshimi të ardhmen, INSTAT është i orientuar gjithnjë e më shumë drejt ndërmarrjes së aksioneve që sjellin ndryshim pozitiv në kuadër të konsolidimit të mëtejshëm të kapaciteteve profesionale në funksion të përvetësimit dhe zbatimit të praktikave më të mira bashkohore, duke synuar kështu prodhimin e statistikave në kohë dhe me cilësi të lartë.

Në zbatim të kërkesave dhe detyrimeve që parashikon Ligji Nr, 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” dhe në përmbushje të objektivave strategjikë dhe operacionalë të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, INSTAT harton këtë strategji trajnimi për të garantuar cilësinë dhe eficiencën për prodhimin e statistikave dedikuar temave të parashikuara në dokumentet e sipërpërmendura, si dhe realizimin e objektivave strategjikë madhor drejt të cilave synon të progresojë Sistemi Kombëtar Statistikor.

Në këtë kontekst rritja e kapaciteteve profesionale të statisticienëve përbën domosdoshmëri jo vetëm në kuadër të zbatimit të aktiviteteve statistikore për plotësimin e nevojave në vend, por edhe për zbatimin e nevojave të jashtme për të dhëna cilësore, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian dedikuar kapitullit 18 “Statistikat”, të cilat synojnë përafrimin gjithnjë e më shumë të statistikave me standardet evropiane.

INSTAT është angazhuar të komunikojë kulturën e përgjithshme statistikore dhe të sigurojë zhvillimin e aftësive, njohurive dhe ekspertizave të veçanta të nevojshme për përmbushjen e misionit të tij në të gjithë grupin e përdoruesve duke e konsideruar thelbësor procesin e organizimit të trajnimeve dhe shërbimeve konsultuese në funksion të përmbushjes së kërkesave gjithnjë e në rritje për prodhimin dhe përdorimin e statistikave zyrtare në vend.

Strategjia e zhvillimit profesional synon të zhvillojë më tej kapacitetet profesionale të sistemit kombëtar statistikor për të qenë efektive dhe që t’i përgjigjen me sukses sfidave aktuale dhe të reja. Ndërkohë, është e domosdoshme që vetë punonjësit të krijojnë dhe mbajnë një qasje të “krijimit të kulturës së të mësuarit”, ose thënë ndryshe ju duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tjera të tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Ndërkohë, nëpërmjet trajnimit dhe zhvillimit të stafit të ri të statistikave synohet të jepen njohuritë bazë, si dhe aftësitë dhe vlerat profesionale, të cilat ju mundësojnë atyre të zhvillohen në vijimësi dhe t'iu përshtaten ndryshimeve gjatë gjithë jetës së tyre profesionale.

2 VIZIONI

Një Sistem Statistikor Kombëtar që të funksionojë në një nivel të krahasueshëm me sistemet statistikore kombëtare më të përparuara në Bashkimin Evropian, duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira për të përfutur statistika dhe tregues, të cilët janë të besueshme nga përdoruesit dhe plotësojnë nevojat e tyre.

3 MISIONI

Sigurimi i statistikave transparente, neutrale dhe në kohën e duhur, të cilat ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë zhvillimin dhe proceset transformuese në fushën e ekonomisë, demografisë, shoqërisë dhe mjedisit, brenda vendit.

4 OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË SISTEMIT KOMBËTAR STATISTIKOR

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritimit Evropian

Objektivi strategjik 2: *Plotësimi i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare*

Objektivi strategjik 3: *Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare*

Objektivi strategjik 4: *Rritja e numrit të institucioneve pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor*

Objektivi strategjik 5: *Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare.*

Objektivi strategjik 6: *Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur*

5 SITUATA AKTUALE

INSTAT si institucioni përgjegjës për koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor harton në bazë vjetore planin e trajnimeve për punonjësit e SKS, dokument i cili shqyrtohet dhe miratohet

ne Bordin e Drejtoreve të Institutit të Statistikave. Trajnimet e parashikuara dhe të kryera në zbatim të këtij dokumenti mbulojnë kryesisht fushat si:

- Njohuri bazë për stafin e ri pjesë e shërbimit civil.
- Metadatat
- Cilësia Statistikore
- Aftësi Drejtuese
- Analiza e të Dhënave – Statistikat Ekonomike
- Analiza e të Dhënave– Statistikat Sociale
- Sistemi i Zbulimit Statistikor (SDC)
- Metodatat e anketimit të ndërmarrjeve ekonomike
- Metodatat e imputimit dhe editimit
- Gjuha R
- Mbetjet e ngurta Urbane
- Njohuri bazë për Statistikat Zyrtare
- Cilësia Statistikore" (niveli baze)
- Mbledhje e të dhënave dhe procesi statistikor
- Njohuri mbi Aktivitetet e Nomenklaturave Ekonomike
- Menaxhimi i Riskut
- Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
- Aftësi drejtuese
- Excel
- Komunikimi, publikimi dhe shpërndarja e informacionit

Trajnimet e mësipërme janë organizuar nga INSTAT me bashkëfinancimin e projekteve SIDA dhe SALSTAT dhe subjekt i këtyre aktiviteteve janë punonjësit e Sistemit Kombëtar Statistikor, si dhe punonjësit e bashkive apo institucioneve të tjera të përfshira në procesin e furnizimit me të dhëna statistikore.

Megjithatë siç dhe është cekur dhe më lart kërkesat gjithnjë e në rritje për të dhëna statistikore implikojnë nevojën institucionale për ndërmarrjen e aksioneve të metejshme për ngritjen e kapaciteteve të duhura për plotësimin në kohë dhe me cilësi të këtyre kërkesave. Procesi i identifikimit të nevojave (i trajtuar në kapitullin pasardhës) është një proces dydimensional i fokusuar në nevojat e shprehura nga vetë punonjësit (nëpërmjet një seksioni të dedikuar trajnimeve në formularin e vlerësimit 6 mujor), si dhe nga ana tjetër i shoqëruar me një analizë dhe vlerësim institucional të situatës aktuale të kapacitetit profesional dhe të nevojave për konsolidim/mbulim të këtyre nevojave. Procesi i vlerësimit të nevojave mbështetet dhe iniciohet nga 'platforma' demografike e burimeve njerëzore të institucionit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa tregues të përbërjes gjinore sipas pozicionit hierarkik:

Kategoria	Femra		Meshkuj		Nr. total
	Nr	%	Nr	%	
Niveli i mesëm dhe i lartë drejtues	7	50%	7	50	14
Niveli i ulët drejtues	26	68%	12	32%	38
Niveli ekzekutiv	81	71%	33	29%	114
Punonjës administrative	6	50%	6	50%	12
INSTAT qendër, total	120	68%	58	32%	178
Zyrat Rajonale	36	73%	13	27%	49
Total INSTAT	156	68%	71	32%	227

Ndërkohë rezulton që nga totali i punonjësve 23 janë punonjës të rinj që kanë marrë statusin e nëpunësit civil.

Nga të dhënat e mësipërme gjenerohen vlerat për tregues si kategoria e punësimit, gjinia dhe numri i punonjësve të rinj, të cilët përbëjnë një kriter të rëndësishëm për tu konsideruar gjatë analizës së nevojave dhe hartëzimit të trajnimeve për mbulimin e këtyre nevojave.

6 VLERËSIMI I NEVOJAVE TË TRAJNIMIT DHE GRUPET E SYNUARA

Në përgatitjen e planeve të trajnimit INSTAT merr në konsideratë:

- a) Identifikimin e nevojave:
 - Kush ka nevojë të trajnohet; dhe
 - Çfarë trajnimesh janë të nevojshme.
- b) Vendosjen e prioriteteve për plotësimin e nevojave të identifikuara.
- c) Monitorimin dhe vlerësimin e performancës së trajnimeve të zhvilluara në vitin paraardhës.

Proces i vlerësimit të nevojave për trajnim realizohet nga Burimet Njerëzore në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse të INSTAT ku identifikohen fushat ku personeli i INSTAT ka të nevojshme rritjen e mëtejshme të aftësive profesionale. Gjithashtu, nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve përdoruesve ju jepet mundësia e shprehjes së interesit të tyre për njohuri mbi fushat e statistikave.

INSTAT duke e vlerësuar aftësimin profesional të stafit si faktor të rëndësishëm në rritjen e cilësisë statistikore në planet e trajnimit i kushton një vëmendje të veçantë përmbushjes së nevojave për trajnim të identifikuar nga vetë punonjësit. Identifikimi i këtyre kërkesave për trajnim kryhet nëpërmjet shqyrtimit të:

- a) tematikave të sugjeruara në formatin standard të vlerësimit të stafit, në të cilin përcaktohen tematikat e kërkuara nga çdo punonjës;
- b) tematikave të sugjeruara në formularin e vlerësimit plotësuar nga të gjithë pjesëmarrësit gjatë trajnimeve të ofruara në vitin paraardhës;
- c) Nevojave për trajnime të paraqitura nga komunikimet zyrtare nga përfaqësues të SKS, përdorues, institucione, etj;
- d) rekomandimeve të adresuara nga organizma ndërkombëtare për zhvillimin e kapaciteteve të statistikienëve;
- e) propozimeve konkrete në ëorkshop-et e organizuar për fushat në të cilat është e domosdoshme të përditësohen e plotësohen njohuritë.

Ndërkohë nga procesi i vlerësimit të nevojave të shprehura nga vetë stafi rezultojnë që përpos temave të zhvilluara deri tani nga INSTAT, kërkesat janë në rritje që në planin e trajnimeve që INSTAT organizon të përfshihen dhe temat si:

- SAS
- SPSS
- Teknikat e Prezantimit
- Shkrim Akademik

Në referencë edhe të Ligjit për Statistikat Zyrtare, grupet e synuara të pjesëmarrësve në trajnime janë si më poshtë:

- a) ***Punonjës të INSTAT*** - me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të reja, si dhe rritjen e mëtejshme profesionale të stafit ekzistues
- b) ***Punonjës të Sistemit Kombëtar Statistikor*** - me qëllim harmonizimin e mendimit statistikor dhe përmirësimin e metodave operative të përbashkëta në punën statistikore
- c) ***Punonjës të institucioneve që disponojnë të dhëna*** - me qëllim ofrimin e njohurive mbi statistikën (njohuri bazë dhe të avancuara) në drejtim të rritjes së aftësive organizative dhe njohurive mbi tipologjinë e informacionit statistikor që kërkohet, metodat e grumbullimit dhe përpunimit të tij.
Përdoruesit, media, etj. - me qëllim rritjen e aftësive të përdoruesve për të kuptuar, komunikuar dhe interpretuar të dhënat statistikore zyrtare.

7 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi, objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë strategji të zhvillimit profesional të statisticienëve dhe përdoruesve të gjerë, reflektojnë kërkesat e Ligjit 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, në rolin që ka INSTAT si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor duke synuar rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikave zyrtare nëpërmjet rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të agjensive statistikore dhe institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare, njohurive statistikore të përdoruesve, si dhe çdo person tjetër të interesuar.

INSTAT, krahas objektivave strategjike dhe planeve të veprimit në drejtim të prodhimit të statistikave zyrtare, konsideron shumë të rëndësishëm ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të përditësuara jo vetëm për personelin e INSTAT, por edhe të agjensive statistikore, medias, përdoruesve të ndryshëm të statistikave zyrtare.

Në këtë kontekst, strategjia e zhvillimit profesional, ka si qëllim rritjen e nivelit të njohurive profesionale, kuptueshmërinë në produktet statistikore dhe njohurive më të thelluara në fushën e prodhimit statistikor për përdoruesit e gjerë.

Objektivat kryesore të Strategjisë së Zhvillimit Profesional në zbatim të objektivave të Zhvillimit të SKS janë:

- a) Garantimi i formimit të duhur i statisticienëve për fushat që mbulojnë në pozicionin specifik brenda organikës së institucioneve të Sistemit Kombëtar Statistikor;
- b) Ngritja e nivelit të njohurisë së përgjithshme dhe specifike që nevojitet për anëtarësimin në BE
- c) Zhvillimi i kapacitetit profesional të punonjësve nëpërmjet ofrimit të njohurive bazë për punonjësit që ngjisin shkallët e karrierës brenda Sistemit Kombëtar Statistikor;
- d) Promovimi i kulturës së mësimi të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional për tu siguruar që punonjësit performojnë duke dhënë potencialin e plotë të tyre;
- e) Rritja e nivelit të njohurive për përdorimin e teknologjisë moderne në punën e përditshme të stafit të INSTAT
- f) Promovimi i interesit tek studentët për fushën e statistikave;

Gjithashtu, krahas objektivave strategjike janë përcaktuar edhe disa objektiva specifike si në vijim:

- a) Organizimi i trajnimeve duke patur si fokus prioritetet aktuale, si: Cilësia statistikore; Përdorimi i burimeve administrative; Njohuri bazë mbi statistikave për administratën publike;
- b) Organizimi i trajnimeve në një sistem të unifikuar;

- c) Organizimi i trajnimeve profesionale si shtesë e kurseve të trajnimit të detyrueshme dhe administrative;
- d) Përqëndrimi i trajnimeve në punën që realizohet aktualisht nga INSTAT, duke zhvilluar aftësitë praktike dhe për tu plotësuar me njohuritë teorike;
- e) Organizimin e trajnimeve cilësore si nga ana e përmbajtjes së temave të trajnimeve ashtu dhe nga niveli i pjesëmarrësve në trajnim;

8 METODOLOGJIA E TRAJNIMIT

Metodologjia e trajnimeve të organizuara nga INSTAT do të fokusohet në formulimin dhe organizimin e trajnimeve duke u mbështetur në praktikatat më të mira të trajnimit dhe mësimdhënies, duke mbajtur në konsideratë parimin e dhënies formë të trajnimit sipas nevojave dhe mundësive aktuale.

Gjatë planifikimit të trajnimeve do të mbahen në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- a) Do të punohet në mënyrë të vazhdueshme për të përshtatur kërkesat për trajnim me objektivat e zhvillimit të INSTAT dhe SKS në tërësi.
- b) Vendosja e objektivave të qartë të trajnimit, gjë e cila ndihmon pjesëmarrësit të kuptojnë pritshmëritë e tyre në drejtim të njohjes, si dhe përcaktimit të metodave dhe mjeteve të trajnimit. Për më tepër, kjo do të ndikojë në vlerësimin e performancës së trajnerëve dhe vetë procesit të trajnimit.
- c) Siguria që çdo trajnim ka në qendër eksperiencën dhe njohuritë e pjesëmarrësve. Trajnimet do të projektohen të tilla që të maksimizojnë ndërveprimin midis teorisë dhe praktikës, po ashtu dhe midis vetë pjesëmarrësve.
- d) Përfshirjen e feedback-ut të pjesëmarrësve gjatë gjithë procesit: para, gjatë dhe pas trajnimit.

Duke synuar rritjen e efektivitetit të trajnimeve dhe qasjen e trajnimit të orientuar drejt rezultateve, do të synohet që trajnimet krahas prezantimeve të shoqërohen me teknika të tjera të cilat e bëjnë trajnimin më interaktiv dhe çdo pjesëmarrës të ndjehet palë e barabartë. Gjithashtu, synohet aplikimi i metodave interaktive për të siguruar një shkallë më të lartë kontributi të secilit pjesëmarrës në trajnim.

Programet e trajnimit do të zhvillohen fokusuar në format e paraqitura më poshtë:

- a) ***Nxitja e pjesëmarrjes aktive:*** Prezantimi i temave nëpërmjet transmetimit të njohurive nga trajneri tek pjesëmarrësit, si dhe zhvillimi i bashkëbisedimit aktiv bazuar në pyetje të cilat nxitin diskutim, vlerësohet si mënyrë efikase për përvetësimin e njohurive të ofruara gjatë fazave të trajnimit. Trajnimi i konceptuar të kryhet duke aplikuar punën në grup për trajtimin e rasteve praktike të hartuara nga trajnerët lektorë i jep hapësirë të gjerë diskutimit të

problematikave të prezantuara nga pjesëmarrësit, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet kolegësh dhe ofruar zgjidhje të larmishme të situatave specifike.

- b) **Rastet praktike:** Zhvillimi i rasteve studimore për temat që trajtohen vlerësohet si domosdoshmëri për të motivuar pjesëmarrësit që të jenë aktivë dhe të shprehin opinionin e tyre apo të japin zgjidhje për situatat konkrete dhe hipotetike të prezantuara.
- c) **Zhvillimi i materialeve të trajnimit:** Përzgjedhja e kujdesshme e informacionit, si dhe hartimi i prezantimeve të përshtatshme për trajnim është një faktor i rëndësishëm në suksesin e trajnimit. Informacioni që do të prezantohet duhet të jetë plotësues i njohurive që ju shërbejnë statistikienëve jo vetëm gjatë trajnimit, por edhe për aplikimin e këtyre njohurive në praktikë. Në këtë kontekst synohet të ofrohen dy lloje kryesore të materialeve të trajnimit:
- **Trajnime të nivelit fillestar.** Të cilat organizohen për orientimin e punonjësve të rinj, me qëllim që të merren njohuritë bazë mbi funksionimin e sistemit të statistikave, proceset e prodhimit të statistikave zyrtare, definicioneve dhe koncepteve bazë, etj.
 - **Trajnime të nivelit të avancuar.** Të cilat organizohen për ekspertët e statistikave që kërkojnë të thellojnë aftësitë e tyre profesionale, në përgjithësi mbi zhvillimin e statistikave, qasja në metodat dhe metodologjitë e reja të përdorura, si dhe në fusha të veçanta statistikore.

9 VLERËSIMI DHE MONITORIMI I PERFORMANCËS SË TRAJNIMIT

Në përfundim të çdo trajnimi, feedback-u/informacioni nga pjesëmarrësit do të sigurohet nëpërmjet një “Formulari të Vlerësimit të Trajnimit” (Aneksi 1), i cili do të shërbejë si bazë për rishikimin e Programit të Trajnimit dhe ofrimin e trajnimeve sa më të përshtatshme dhe të cilësisë së lartë për stafin si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Vlerësimi i performancës së Trajnimit do të përfshijë: vlerësimin e performancës dhe nivelit të trajnuesit/lektorit, metodat dhe format e trajnimit, përmbajtja dhe përshtatshmëria e tematikave të përzgjedhura, lehtësirat dhe mjaftueshmëria e materialeve të trajnimit etj.

Monitorimi i zbatimit të Programit të Trajnimit konsiderohet shumë i rëndësishëm për procesin e zhvillimit profesional të statistikienëve, pasi ofron informacion të vlefshëm dhe në kohë për t’u siguruar se veprimtaritë po kryhen sikurse ishin parashikuar në Program dhe ndihmon që veprimet korrigjuese të ndërmerren në kohë dhe që po ecet në drejtim të plotësisë së objektivave.

Burimet Njerëzore do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin me rigozitet të Programeve të trajnimit, duke raportuar në mënyrë periodike dhe sa herë që është e nevojshme

dhe kërkohet tek nivelet drejtuese. Gjithashtu, në përfundim të programit vjetor të trajnimit përgatitet nga Burimet Njerëzore një raport i detajuar mbi ecurinë e programit, problematikat e hasura dhe çështje për t'u mbajtur në konsideratë në trajnimet e ardhshme.


10 TRAJNIMET E OFRUARA DHE CAKTIMI I PJESËMARRËSVE

Në kuadër të zhvillimit profesional llojet e trajnimeve që ofrohen janë si më poshtë:

- a) **Trajnime të organizuara nga INSTAT** bazuar në Planin vjetor të Trajnimeve të miratuar nga Bordi Drejtues. Pjesëmarrja në këto trajnime është e parashikuar në Planin Vjetor të trajnimit.
- b) **Trajnime të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).** ASPA në bashkëpunim me Institucionet harton planin vjetor të trajnimeve dhe në mënyre periodike komunikon ne lidhje me zhvillimin e temave të trajnimeve për pjesëmarrjen e punonjësve pjesë e shërbimit civil. Burimet Njerëzore shpërndajnë informacionin mbi trajnimet e ofruara nga ASPA tek Drejtoritë përkatëse sipas përshtatshmërisë së temave dhe në vijim caktohet nga Drejtorët stafë që do marrë pjesë në trajnim.
- c) **Trajnime të organizuara nga Organizmat ndërkombëtare të cilat mbështesin financiarisht INSTAT** në plotësimin e nevojave të tij, përmes projekteve të caktuara, të tilla si BE, SIDA dhe SDC. Si pjesë e aktiviteteve të projekteve janë të planifikuara edhe aktivitete në kuadër të rritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve të ndryshme, ëorkshope apo vizitave studimore. Gjithashtu, organizma të tjerë si UN, UNECE dhe SESRIC ofrojnë trajnime ad-hoc sipas nevojave për zhvillimin e statistikave në fusha specifike. Pjesëmarrja në këto aktivitete miratohet nga Titullari i institucionit.
- d) **Trajnime të organizuara nga Organizmat ndërkombëtare, të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Joint Vienna Institute apo Banka Botërore.** Këto organizma ofrojnë trajnime/kualifikime të ndryshme për stafin e institucioneve qeveritare në kuadër të zhvillimit profesional dhe përafrimit të praktikave të punës me metodologjitë bashkëkohore. Për të gjitha trajnimet me interes në këto organizma, stafë i INSTAT merr konfirmimin e Titullarit të institucionit, duke vendosur në dijeni burimet njerëzore.
- e) **Trajnime të organizuara nga Programet IPA.** INSTAT së bashku me agjensitë statistikore (Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë) janë përfitues dhe kanë një pjesëmarrje aktive në Programin e Trajnimeve të Statistikave Europiane (ESTP). Qëllimi ESTP është që t'ju sigurojë statistikienëve trajnim të vazhdueshëm me metodat e reja, teknikat dhe praktikatat më të mira, integrimin, zbatimin e koncepteve dhe përkufizimet europiane. Pjesëmarrja në këto aktivitete miratohet nga Titullari i institucionit dhe vendosur në dijeni burimet njerëzore.
- f) **Trajnimet ad-hoc.** Në zbatim të objektivave për mbulimin sa më të plotë të stafit me njohuritë e nevojshme do të merren masat që nëpërmjet planeve vjetore të pasqyrohen dhe trajnimet ad-hoc, kërkesa për të cilat duhet të behet paraprakisht nga drejtoria përkatëse.

PROGRAMI VJETOR I TRAJNIMIT

INSTAT bazuar në këtë strategji të zhvillimit profesional harton dhe miraton çdo vit në Bordin e Drejtorëve Planin vjetor të trajnimeve. Ky program trajnimi për vitin 2022 është hartuar bazuar në katër hapat kryesorë si më poshtë:



Fazat e hartimit të programit vjetor të trajnimit:

- Vlerësimi i Nevojave
- Prioritizimi i temave të trajnimit
- Vlerësimi i Burimeve/Fokus grupet
- Programit të Trajnimit dhe Trajnerët
- Kalendari i Trajnimit